



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA ESHTRA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primenjë Më/Cane			
18-03-2019			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetli Prillog	Vlera Vrednor
01-070/01-279			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 36, paragrafi 2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e mbajtur më datën 18.03.2019, miraton këtë:

DEKLARATË

Kuvendi Komunal i Vitisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 18.03.2019, lidhur me moskyqjen e Komunës së Vitisë në autostradën “Arbër Xhaferi” në Gerlicë, shprehë shqetësimin dhe pakënaqësinë e tij, që edhe pas 3 viteve të nxjerrjes së Deklaratës të datës 31.10.2016 të Kuvendit Komunal të Vitisë, nuk ka asnjë veprim konkret lidhur me kyqjen në autostradën “Arben Xhaferi” në Gerlicë. Prandaj, ne përfaqësuesit e partive politike, në emër të gjithë qytetarëve të komunës sonë, nëpërmjet kësaj deklarate drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë për Infrastrukturë, kërkojmë që të adresohet kërkesa dhe nevoja e qytetarëve të Komunës së Vitisë për mundësimin e kyqjes në autostradën “Arbën Xhaferi”.

Kjo kërkesë përfaqëson vullnetin e mbi 50 mijë qytetarëve.

Gjithashtu kërkojmë takime me:

1. Kryeministrin e Republikës së Kosovës.
2. Kryeparlamentarin e Republikës së Kosovës.
3. Përfaqësuesit regjional.
4. Ne rast të mosrealizimit të kyqjes në Gerlicë, do të vazhdojmë me protesta.

Nisur nga arsyeshmëria e kërkesës dhe nevojës së madhe të qytetarëve, Kuvendi Komunal i Komunës së Vitisë, miraton këtë deklaratë, përmes të cilës kërkon, që Qeveria e Republikës së Kosovës, të modifikojë projektin me qëllim të zhbllokimit të banorëve të Komunës së Vitisë dhe të u mundësojë qasje në Autostradën “Arbër Xhaferi”.

Viti, më 18.03.2019

KRYESUES I KUVENDIT

Naim Pira

